

## Projekti Shqiptaro-Zviceran për Pronësinë Intelektuale (ALSIP)

**Objektivi i projektit është të kontribuojë që sipëmarrësit, krijuesit, kerkuesit dhe prodhuesit të përfitojnë nga mbrojtja efektive e objekteve të pronësisë intelektuale.**

### Historiku i projektit dhe konteksti

Në dy dekada Shqipëria ka bërë progress ekonomik të konsiderueshëm ekonomik dhe ka hartuar legjislacion mbi pronësinë industriale, të drejtën e autorit, varietetet e bimëve, dizajnin dhe qarqet e integruara. Është duke u anëtarësuar në mjaft konventa dhe traktate ndërkombëtare mbi pronësinë intelektuale dhe ka nënshkruar disa Marrëveshje të Tregtisë së Lirë me rajonin dhe më gjërë.

Për ta përshpejtuar këtë, reformat strukturore synojnë të rrisin produktivitetin dhe konkurrencën, të krijojnë më shumë vende pune dhe të përmirësojnë qeverisjen dhe ofrimin e shërbimeve publike.

Strategjia Kombëtare e Pronësisë Intelektuale (PI) të Shqipërisë përcakton se sistemi i PI do të jetë ai që “siguron mbrojtje efektive të objekteve të PI, inkurajon kreativitetin dhe inovacionin në shërbim të stimulimit të rritjes ekonomike dhe zhvillimit kulturor e shkencor në Republikën e Shqipërisë”.

Sfidat ndaj sistemit që ende mbeten ndër të tjera, kanë të bëjnë me nevojën për të zhvilluar dhe zbatuar më tej Strategjinë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale, për të parandaluar dhe luftuar piraterinë dhe falsifikimet e vazhdueshme, rritjen e ndërgjegjësimit për PI-në si dhe forcimin dhe ngritjen e kapaciteteve të subjekteve të specializuara të PI.

Projekti ALSIP mbështet zhvillimin e kapaciteteve të institucioneve shqiptare të PI për të konsoliduar kushtet e përmirësuara për bizneset, konkurrencën e tyre dhe në përgjithësi për sistemet e tregut.

### Objektivat

Projekti ALSIP përfshin objektivat e mëposhtme:

- Përmirësimin e legjislacionit të PI dhe zbatimin efektiv të Strategjisë Kombëtare të IP duke kontribuar në kushte më të mira kornizë për investime dhe inovacion.
- Funksionimi më i mirë i subjekteve të regjistrimit dhe administrimit të të drejtave të PI, duke ofruar shërbime efikase dhe miqësore për përdoruesit.
- Subjektet e PI, përfaqësuesit privatë dhe akademikë të forcohen në promovimin e blerjes, përdorimit dhe transferimit të të drejtave të PI-ve tek përdoruesit e mundshëm.
- Forcimi i zbatueshmërisë së të drejtave të PI
- Rritja e ndërgjegjësimit për rëndësinë e komercializimit të transferimit të teknologjisë dhe PI si pjesë e procesit të inovacionit

### Fakte të përgjithshme mbi projektin

#### Kohëzgjatja e projektit

4 vjet (2020 – 2024)

#### Buxheti i përgjithshëm

1,500,000.00 CHF

#### Agjencia donatore

Sekretariati i Shtetit për Cështjet Ekonomike **SECO**

#### Partnerët zbatues

- Insituti Federal Zviceran për Pronësinë Intelektuale **IPI**
- Drejtorja e Përgjithshme e Pronësisë Industriale **DPPI**
- Drejtorja e së Drejtës së Autorit **DDA**

#### Konteksti i Shqipërisë

Popullësia: 2.8 million

Sipërfaqja: 28,748 km<sup>2</sup>

Rritja vjetore e PBB: 3,4%

Rritja vjetore e PBB për capita: 13,350 USD

## Aktivitetet

Projekti ofron këshilla dhe mbështetje të specializuar në fusha të zgjedhura, në nivele të ndryshme ku Zvicra është në gjendje të ofrojë ekspertizë të fortë dhe të realizojë aktivitete për të rritur ndërgjegjësimin, për të ofruar informacion dhe përvijën përkatëse, dhe në vecanti në ngritjen e kapaciteteve të sistemit të PI dhe të individëve.

Në nivel politikash, projekti mbështet rishikimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare të PI (2021-2025), në mënyrë që institucionet e PI dhe përdoruesit e të drejtave të PI midis popullatës shqiptare, të jenë më në gjendje të përfitojnë nga mundësitë që ofron sistemi i PI. Këtu, projekti mbështet rishikimin dhe përgatitjen e legjislacionit të ri të PI.

**Ngritja e kapaciteteve teknike** nëpërmjet trajnimeve, seminareve dhe **shkëmbimit të eksperiencave** ndërmjet homologëve zviceranë dhe shqiptarë, programeve arsimore dhe kontributit të ekspertëve, synojnë ngritjen e cilësisë së shërbimeve të regjistrimit dhe administrimit të PI të DPPI-së dhe Drejtorisë së të Drejtave të Autorit. Paralelisht, përmes **programeve të informimit** dhe moduleve të trajnimit, projekti mbështet promovimin, përdorimin dhe përvetësimin e të drejtave të PI nga grupe specifike të synuara, për të rritur përdorimin dhe komercializimin e PI, për shembull përmes shërbimeve të **transferimit të njohurive dhe teknologjisë**. Në fushën kundër falsifikimit, zhvillohen trajnime dhe vihen në dispozicion burime të dobishme informacioni për të lehtësuar procedurat operative dhe për të mundësuar më tej gjyqësorin, doganat, mbikëqyrjen e tregut dhe agjencitë e tjera të zbatimit të PI në rolet e tyre. **Fushatat edukative publike** dhe shkëmbimet mbi përvojat **kundër falsifikimit** janë ngritur gjithashtu për të sensibilizuar publikun e gjerë kundër piraterisë dhe falsifikimit. Së fundmi, si një mjet zhvillimi dhe marketingu socio-ekonomik, do të zhvillohet promovimi i ndërgjegjësimit rreth **Treguesve Gjeografikë (TGJ)** dhe potencialit të TGJ-ve shqiptare drejt krijimit të një inventari TGJ.

## Përafrimi me prioritetet e zhvillimit të Shqipërisë

Projekti ALSIP është në përputhje me **prioritetet kyçe të zhvillimit social-ekonomik të Qeverisë së Shqipërisë**. Projekti ALSIP mbështet Shqipërinë në zbatimin e vizionit të mirë-artikulluar në strategjinë e saj Kombëtare të PI në lidhje me një sistem PI, në veçanti për të garantuar regjistrimin dhe mbrojtjen efektive të objekteve të PI. Kjo mund të inkurajojë kreativitetin dhe inovacionin për të stimuluar rritjen ekonomike dhe zhvillimin kulturor e shkencor në vend.

Për më tepër, ngritja e markave të forta vendase, mund të çojë më tej konkurrencën e kompanive shqiptare jashtë vendit. Kjo nuk është vetëm në interes të Shqipërisë, por edhe në dobi të Zvicrës, pasi kompanitë mund të mbështeten në mbrojtjen efektive për të drejtat e pronësisë së tyre.

## Përfituesit

Përfituesit kryesorë të projektit janë **Drejtorja e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI)** dhe **Drejtorja e së Drejtës së Autorit (DDA)**. Përfitues të mëtejshëm përfshijnë aktorë të tjerë të sistemit kombëtar të PI si: **Policia e Shtetit, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT), Drejtorja e Përgjithshme e Doganave, Shkolla e Magjistraturës, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Kulturës, Organizatat e Menaxhimit Kolektiv, Unioni i Dhomave të Tregtisë, Universitetet, konsulentët e PI (avokatët e PI, konsulentët e transferimit të teknologjisë); dhe shoqatat e përzgjedhura të prodhuesve të TGJ.**

Në veçanti, kompanitë shqiptare, universitetet lokale dhe individët mund të përfitojnë gjithashtu nga një sistem i përmirësuar funksional të PI në drejtim të nxitjes së inovacionit. Po kështu, konsumatorët mbrohen më tej nga falsifikimet.

### Më shumë informacione dhe Kontakte

**Olga Allemann and Nathalie Hirsig – Koordinatorë të Projektit ALSIP**

Instituti Federal Zviceran për Pronësinë Intelektuale - IPI

[olga.allemann@ipi.ch](mailto:olga.allemann@ipi.ch); [nathalie.hirsig@ipi.ch](mailto:nathalie.hirsig@ipi.ch) / +41 31 377 77 77

**Borana Kalemi - Përgjegjëse e Projektit ALSIP/Shqipëri**

[Borana.kalemi@swisscontact.org](mailto:borana.kalemi@swisscontact.org)